



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:064833

Datë: 19.06.2019

Numri i dokumentit: 00366884

P.nr.1049/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN/ Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Veli Kryeziu, me sekretaren juridike Fikrije Rexhepi , ne çështjen penale ndaj të pandehurve B... M... nga Gj..., të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron av....., për shkak të veprës penale sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, dhe L... H... nga Gj..., të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron av..... për shkak të veprave penale, sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës dhe asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.Nr.1701/2018 të datës 16.11.2018, të cilën e përfaqëson prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu , pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar më datë 05.06.2019 publikisht shpalli, ndërsa më 19.06.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I

I pandehuri **B...M...**, nga i ati A..., e ëma E..., e lindur B..., i lindur më..., në Gj..., ku edhe jeton rr."...." nr...., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i papunësuar, i gjendjes së varfër ekonomike shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa dënuar.

II

I pandehuri **L... H...**, nga i ati G..., e ëma Sh..., e lindur I..., i lindur më..., në Gj..., ku edhe jeton rr."...." nr...., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i një fëmije, i papunësuar, i gjendjes së varfër ekonomike , shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa dënuar.

JANË FAJTORË

S E P S E

I

Të pandehurit B... M...dhe L..H...:

Më datë 20.10.2018, rreth orës 01:45 minuta, në restorantin “...”, në dalje nga Gj..., në rrugën e K..., të pandehurit në gjendje të dehur me dy tre shokët e tyre shkojnë tek ky restorant, të cilët fillojnë ta prishin rendin dhe qetësinë publike, duke thyer gota dhe në këtë lokal rastisin që të jenë tre zyrtar policor, Xh... R..., A... M... të uniformëm dhe D... K... me rroba civile, të cilët ua tërheqin vërejtjen të dyshuarve që të mos ta prishin rendin dhe qetësinë publike, me atë rast i dyshuari B... u kishte thënë ”kush k... po fol aty” dhe me tu prezantuar me kartelë të identifikimit zyrtari D..., ky i dyshuar i drejtohet me një ton kërcënues “kush k... je ti, i vogël je ti”, dhe me sjellje të tyre tejet arrogante kanë shkuar në drejtim të zyrtarëve policor për ti sulmuar fizikisht dhe për të zbrapste sulmin e të pandehurve zyrtari policor..., me sprehin zyrtar ua hedhë në fytyrë të dyshuarve, dhe përkundër sprehit të hedhur të pandehurit i sulmojnë këta zyrtar policor, ku i dyshuari B... arrit ta godas policin Xh... me grushtin e djathtë në trup, në gjoks në pjesën e qafës, deri sa L... e shtyn me duar këtë zyrtar policor dhe gjatë kësaj rrëmuje të krijuar në këtë vend publik, të dyshuarit ikin nga vendi i ngjarjes.

-me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, **sulmi ndaj personit zyrtar gj atë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.**

II

I pandehuri L... H...:

Me datën, kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitivin e I të kësaj aktakuze, pandehuri në gjendje të dehur, derisa ishte në restorantin-kafe “...”, pas prishjes së rendit dhe qetësisë publike në këtë restorant, dhe tërheqjen e vërejtjes nga personat zyrtar, që mos ta prishin këtë rend, i dyshuari, ka shkelmuar duke demoluar karrigat në tokë, merr një tavolinë e ngritë lart, e hudhë mbi tavolinën tjetër, duke i dëmtuar që të dyjat.

-me çka ka kryer veprën penale, **asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 paragrafi 1 të KPRK-së**

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore si dhe neneve, 4,7,31,41,42,43,45,46, 47,73,74,75,83 si dhe nenit 365 të Kodit Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të pandehurit:

I G J Y K O N

Të pandehurin **B... M... me dënim me burgim** në kohëzgjatje prej njëqindetpesëdhjetë (150) ditëve, ashtu që dënimi i shqiptuar do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm.

Të pandehurin **L... H...** sa i përket dispozitivit **I** shqipton, **dënim me burgim** në kohëzgjatje prej njëqindetpesëdhjetë (150) ditëve, dhe sa i përket dispozitivit **II**, i shqipton **dënim me gjobë** në shumë prej treqind (300) euro.

II. Në bazë të nenit 80, paragrafi 2, nënparagrafi 2.5 të KPRK-së, të pandehurit **L.... H...** i shqipton **dënim unik me burgim** në kohëzgjatje prej njëqindetpesëdhjetë (150) ditëve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm. Dhe **dënim unik me gjobë** në shumë prej treqind (300) euro, të cilin duhet ta përmbush në dy këste të barabarta prej nga 150 euro në muaj, duke filluar nga dita pasuese plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, mirëpo nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 të KPP-ës, dënimi me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesmbëdhjetë (15) ditëve, duke filluar nga dita pasuese e pranimit të ftesës për mbajtje të dënimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

III. Në bazë të nenit 47 të KPP-së, dhe me pëlqimin e të pandehurvedënimi me burgim në kohëzgjatje prej njëqindetpesëdhjetë (150) ditëve secilit prej tyre, i'u zëvendësohet në dënim me gjobë në shumën prej njëmijëegjashtëqind (1600) euro, secilit prej tyre. Nëse të pandehurit nuk e paguajnë dënimin me gjobë, dënimi me gjobë revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me burgim.

IV. Në bazë të nenit 83 të KPP-së, të pandehurve **B...M... dhe L... H...,** në dënimet e shqiptuara, t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data **28.10.2018 deri më 23.11.2018.**

V. Të dëmtuarit....., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

VI. Të pandehurit....., obligohen të paguajnë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej nga 30.00 € (tridhjetë euro), si dhe taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në shumën prej 30.00 € (tridhjetë euro), në bazë të nenit 39 paragrafi 3, nën paragrafi 1.3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit,

secili prej të pandehurëve, në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

1. Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, me datë 16.11.2018 ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1701/2018, kundër të pandehurve B.M....për shkak të veprës penale për shkak të veprës penale sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës dhe L. H.t për shkak të veprave penale për shkak të veprës penale sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës dhe Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 paragrafi 1 i KPRK-së. Në shqyrtimin fillestar të datës 05.06.2019, në të cilin ishin prezent Prokurorja e Shtetit Kujtesa Fazliu, të pandehurit B... M..., me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare av....., dhe L... H... me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare av.Sh...Xh... nga Gj.... Në të cilën seancë të pandehurit B... M.... dhe L....H... pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, deklarohen se e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohen, dhe se e pranojnë fajësinë për kryerjen e veprës penale.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurores së shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurve....., për kryerjen e veprave penale për të cilën akuzohen, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se të pandehurit e kanë kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se të pandehurit nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se të pandehurit....., kanë kryer veprat penale, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave së të pandehurve, i ka shpallur fajtor të pandehurit B...M... për shkak të veprës penale Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 paragrafi 2, lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, dhe L... H... për shkak të veprave penale Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 paragrafi 2, lidhur me nenin 31 të KPRK-ës dhe Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 paragrafi 1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtëve i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën janë edhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se të njëjtit e kanë pranuar edhe vet.

Në bazë të nenit 410 paragrafi 2, lidhur me nenin 31 të KPRK-së sulmi ndaj personit zyrtar, konsiderohet:

Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare 1. Kushdo që sulmon ose kanoset seriozisht se do ta sulmojë personin zyrtar, gjyqtarin, prokurorin apo personin i cili ndihmon në kryerjen e detyrave zyrtare lidhur me sigurinë e përgjithshme, sigurinë e Republikës së Kosovës apo ruajtjen e rendit publik, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet. 2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të lehtë trupor të personit zyrtar apo ndihmësi të tij ose përfshin kanosje për përdorimin e armës apo mjetit të rrezikshëm, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Neni 31. Bashkëkryerja Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale.

Neni 333. Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë 1. Kushdo që e asgjëson, dëmton apo e bën të papërdorshme pasurinë e personit tjetër në rrethana tjera nga ato të përcaktuara në nenin 334 të këtij Kodi, dënohet me burgim deri në një (1) vit.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit, ka vlerësuar se të pandehurveti shqiptohet dënimi me burgim dhe me gjobë, ngase ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, të cilat duke i ndërlidhur njëra me tjetrën, janë vlerësuar rrethana posaçërisht lehtësuese, ky dënim do të jetë një dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit të të pandehurve, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenin 73 dhe 76 të KPRK-s, Kështu, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka zbutur dënimin ndaj të pandehurve ka shqiptuar dënim nën minimumin e posaçëm, është fakti se të pandehurit kanë pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, me date 01.11.2018. Gjithashtu, si rrethana posaçërisht lehtësuese, gjykata ka marrë dhe faktin se të pandehurit kanë bashkëpunuar me prokurorinë e shtetit, se pranimin e fajësisë e kanë bërë në të gjitha fazat e procedurës penale, se të pandehurit janë penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale, dhe se të njëjtit i kanë premtuar gjykatës se nuk do të kryejnë vepra tjera penale, kanë treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit fillestar. Këto janë rrethana, që tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe të pandehurit me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra tjera penale. Ndërsa, rrethanë rënduese është se i kanë sulmuar zyrtarët policor.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurve dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Gjykata, ka konstatuar se me dënim burgim dhe dënim me gjobë, mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi llogaritjen e kohës së kaluar paraburgim.

Në bazë të nenit 83 të KPP-së, të pandehurve....., në dënimet e shqiptuara, t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 28.10.2018 deri më 23.11.2018.

8. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Duke bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPPK-së, palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike nuk janë udhëzuar në kontest civil sepse kanë hequr dorë.

9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurve, gjykata, duke u bazuar në nenin 453 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurit ti obligoj të paguajnë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej nga 30.00 € (tridhjetë euro), si dhe taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në shumën prej 30.00 € (tridhjetë euro), në bazë të nenit 39 paragrafi 3, nën paragrafi 1.3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit. secili prej të pandehurve, në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
Divizioni Penal
P.nr. 1049/18, më 19.06.2019

Sekretarjajuridike,
Fikrie Rexhepi d.v

Gjyqtari,
Veli Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.